



REPUBLIKA E KOSOVËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



Nr. 2268 Prot.

Nr. 70 Prot.

*Prishtinë*

*Më dt.18 mars 2022,*

**ODA E STOMATOLOGËVE TË KOSOVËS**

**URDHRI I STOMATOLOGUT TË SHQIPËRISË**

arrijnë këtë

**MEMORANDUM BASHKËPUNIMI**

Palët bien dakord:

1. Të inkurajojnë vizitat dhe takimet dypalëshe duke përfshirë ftesa për ngjarjet më të rëndësishme në fushën e stomatologjisë;

2. Të bashkëpunojnë për zbatimin e mbikëqyrjes profesionale si dhe në fusha të veçanta të mbrojtjes së interesave dhe reputacionit të ndërsjelltë;
3. Të organizojnë aktivitete të përbashkëta në fushën e EVP, si: ligjërata, kongrese/konferenca, tubime shkencore, seminare, simpoziume, trajnime dhe forma të tjera të aktiviteteve, me qëllim të ngritjes profesionale të stomatologëve në të dy vendet tona;
4. Të bashkëpunojnë në fushën e publikimeve dhe promovimit të shëndetit oral;
5. Të shqyrtojnë dhe aprovojnë projekte kërkimore të përbashkëta;
6. Të marrin pjesë në botime të përbashkëta në revistat profesionale;
7. Të bashkëpunojnë në aktivitetet ndërkombëtare dhe të mbështesin njëri - tjetrin;
8. Shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit do të jenë në bazë të reciprocitetit;
9. Ky memorandum lidhet në afat të pacaktuar. *Palët* mund të bien dakord në çdo kohë për përfundimin e këtij memorandumimi;
10. Marrëveshja është shkruar në dy kopje origjinale, një për secilën palë dhe hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

**Për Odën e Stomatologëve të Kosovës**

Kryetari:

Prof. Dr. Blerim Kamberi



**Për Urdhrin e Stomatologut të Shqipërisë**

Presidenti:

Dr. Nikoll Deda

